



Mbrojtja e hardhise nga hiri dhe qendrueshmeria e disa kultivareve ndaj patogjenit

(Resource ID: 308)

Ismajl Cacaj

ismajl.cacaj(at)unhz.eu

This teaching resource is allocated to following University:

UPHZ - University of Peja "Haxhi Zeka"

Institution:

University Haxhi Zeka

<http://www.sustainicum.at/sq/modules/view/308.Mbrojtja-e-hardhise-nga-hiri-dhe-qendrueshmeria-e-disa-kultivareve-ndaj-patogjenit>



Puna ne grup



**5 deri ne 10
studente**



**Deri në 3 njësi
leksionesh**



**Lidhja me Web
e nevojshme**



Anglisht, Shqip

Qëllimi i këtij projekti është që të vlerësohet qëndrueshmeria e kultivareve të hardhisë ndaj patogjenit të hirit (*Uncinula necator*) si dhe të provohet efekti i disa fungicideve aktuale kundër hirit të hardhisë. Studimi është bërë në kultivaret e rrushit Frankovka, Hamburg dhe Thanec gjatë vitit 2014 në komunën e Deçanit por për të pasur rezultate edhe më të qëndrueshme si dhe për të fituar përvojë më të mirë fermeret në mbrojtjen e hardhisë kundër hirit; mendohet se hulumtimi duhet të vazhdojë edhe një apo dy vite të tjera. Pra, subjekt i këtij projekti do të jetë vazhdimësia e tij. Studentët nga afër do të shohin dhe eksperimentojnë me kultivarët e hardhisë dhe do të jenë të përgatitur për tregun e punës në të

ardhmen.

Studentet do të mesojnë nga fermeret se si hiri mund të ulë rendimentin edhe mbi 50% dhe qëllimi i këtij hulumtimi është të vlerësohet qëndrueshmëria e kultivareve të hardhisë ndaj patogjenit të hirit si dhe të provohet efekti i disa fungicideve aktuale kundër hirit të hardhisë. Për të pasur rezultate edhe më të qëndrueshme njëjti hulumtim duhet të bëhet së paku edhe një apo dy vite si dhe që të krihet vetëdija më e lartë e farmereve për mbrojtjen efikase të hardhisë kundër hirit dhe kjo do të përgatise studentet për aktivitete të ngjashme në të ardhmen. Gjatë këtij hulumtimi do të angazhohen së paku 10 studentë (për tju dhënë ndihmën e duhur gjatë gjithë vegjetacionit farmereve dhe për të mesuar mbi kohën e spërkatjeve si dhe llojet e preparative që duhet përdorur për spërkatje, të bëjnë vlersimin e sëmundjes dhe përpunimin e rezultateve edhe me ndihmën e profesorit).

Mbrojta e hardhisë së rrushit nga hiri, në mënyrë të vecantë në ferma të mëdha nënkupton qëndrueshmëri të atij biznesi dhe synohet që një pjesë e studentëve të punësohen në këto ferma.

Mjetet e mësimdhënies



Ekskursion ose field trip

Integrimi i palëve të interesuara shoqërore

Universiteti Haxhi Zeka nga Peja, respektivisht fakulteti i Agrobiznesit ka për qëllim që studentëve të ju ofroj sa më shumë të fitojnë dije nga puna praktike. Këto vizita-praktika i mundësojnë studentëve të ambientohen në kushtet e prodhimit vendor. Vizita në ferma do ju lejojë studentëve të familjarizohen me produktet lokale. Fermeret do të bashkëpunojnë ngushtë me studentët në aktivitetet e parapara në këtë material mesimor duke organizuar workshope dhe duke bashkëpunuar me studente në punë praktike.

Pika e forte

- metodat se si të mbrohen hardhite e rrushit
- nderlidhja e studentëve me vreshtaret

Pika e dobët

- Është normale që çdo prodhues të ketë fshehtësi të veta, për këtë arsye nevojitet një mirëbesim ndërmjet studenteve dhe fermerëve,
- Mos të transmetohen jashtë fermerëve recetat e ndryshme të prodhimit apo ndonjë e mëte e vogël e që ndikon negativisht në rritjen e hardhisë së rrushit. Por të gjitha të diskutohen brenda fermerëve dhe stafit të fakulteteve të Universitetit.

Rezultatet e të mësuarit

Studentët do të mësojnë teknikat të cilat përdoren për mbrojtje të hardhisë së rrushit nga hiri dhe do të jenë më të përgatitur për të ardhmen; Studentët do të mesojnë të implementojnë mësimet e marra për të ardhmen e tyre dhe të jenë më të përgatitur për të.

Lidhja për qëndrueshmëri

Duke ditur rëndësinë e hardhisë së rrushit që mund të përdoret si ushqim dhe perpunim të pijeve alkoolike duhet të ruhet shumë nga hiri patogjen në mënyrë që të kemi qëndrueshmëri të prodhimit. Vlen të theksohet se me një produkt cilësor, kemi një biznes cilësor. Në një të ardhme të afërt kur studentët të jenë në tregun e punës do të kenë më të lehtë të përballen me probleme dhe aktivitete të tilla dhe do të jenë të aftë të krijojnë biznese të qëndrueshme.

Njohuri paraprake

Njohuri baze për studentët të cilët do të marrin pjesë në aktivitete.

Përpjekjet e përgatitjes

Mesatare

Përshkrimi i përpjekjeve të përgatitjes

Përgatitja për mësim 3-5 orë përfshirë edhe udhëtimin në fushë. Nuk është e nevojshme që profesori të gjejë fonde sepse fakulteti mbështet këtë aktivitet. Nëse ka të gjetura të reja dhe të papritura ato do të prezantohen përpara studentëve dhe palëve të tjera të interesuara.

Aksesi

Free

Gjykimi / vlerësimi

Asnje

Kreditim/Çertifikatë

Asnje

Burime dhe lidhje

Butt,D.J. (1988): ((Ell.&Ev.) Salmon.p.263-265 European Handbook of Plant Diseases. BlackwellScient. Public. Oxford,London,Edinburg.

Bici,I (2011): Manuali i produkteve për mbrojtjen e bimëve, botimi I,86, 136 – 137,175 – 176,Tiranë,Shqiperi.

Ciglar,I.(1988): Integral na zaštitavo aka i vinograda,116, akovec, Hrvatska

Susuri,L.(2004): Fitopatologjia,162 – 165 Prishtinë, Kosovë

Kišpati,J.(1987): Bolestivo aka I vinove loze,113,Zagreb,Hervatska.

Kišpati,J.(1986): Fungicidi,149,Zagreb,Hervatska.

<http://research.wineaustralia.com/wp-content/uploads/2012/09/2010-03-FS-Powdery-Mildew-Managing.pdf>

<https://www.youtube.com/watch?v=33QOuP4odh4>

Financuar nga

This teaching resource, realised within the project ConSus, has been funded with the support of the TEMPUS of the European Union. The contents reflect the views of the authors, and the European Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.